

Regjistrimi

Si të regjistrohesh në FSI?

Regjistrimi në studimet e nivelit bachelor:

Të drejtë pranimi në FSI kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Të drejtë konkurimi kanë edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.

Kandidatët jo kosovar konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe që nuk kanë nënshtetësi të Kosovës.

Dëshmia për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës merret në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ndërsa barasvlera e notave do të bëhet në e FSI-së.

Kandidati duhet të sjellë këto dokumente:

- a) *Ekstraktin e lindjes (në origjinal), jo më e vjetër se 6 muaj;*
- b) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme;*
- c) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme;*
- d) *Dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës;*
- e) *Kopjen e letërnjoftimit;*
- f) *Certifikatën shëndetësore;*
- g) *Fletëaplikimin;*
- h) *Dokumentin e nostrifikimit të diplomës për ata që kanë përfunduar shkollimin e mesëm jashtë vendit,*

Regjistrimi në studimet e nivelit master:

Kandidatët që konkurrojnë për studime master në FSI duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë përfunduar studimet sipas sistemit 4 vjeçar (240 ECTS)
2. Të kenë arritur notën mesatare **7.00** e më tepër, gjatë studimeve në nivelin (BA) bachelor.
3. Kandidatët e kanë obligim njohjen e gjuhës arabe, ose ndonjëerën prej gjuhëve tjera, si angleze, frënge etj. Për çka duhet të sjellin certifikatë e cila dëshmon një gjë të tillë.

Kandidatët që konkurrojnë për studime master në FSI duhet t'i sjellin këto dokumente:

1. Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet nga web-faqja (www.fsi-edu.net) ;
2. Ekstraktin e lindjes (origjinale)
3. Diplomën origjinale ose të noterizuar, përkatësisht certifikatën e diplomimit;
4. Kandidatët që kanë përfunduar studimet (BA) bachelor në universitete të huaja duhet ta sjellin diplomën e nostrifikuar.